VENDIM
Nr. 84, datë 9.6.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "BIOPOWER GREEN ENERGY" SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS NR. 64, SERIA NPM08P, TË DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 90, DATË 6.8.2008, E NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë të elektrike"; nenit 5 dhe 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së një licence"; nenit 16, pika 2 dhe 18 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar; germat "a", "d", "e", të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008 të Bordit të ERE-s, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 64, seria NPM08P, datë 6.8.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k., për shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës;
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:
- vendimin e Bordit të Komisionereve nr. 20, datë 8.3.2010;
- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 93, datë 6.9.2011;
- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 137, datë 15.11.2013.
- Me shkresën me nr. 4/15 prot., datë 3.4.2015, shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 12 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 90, datë 6.8.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin nr. 137, datë 15.11.2013.
- Mospërmbushja e pikës 1, germa "e", të vendimit 90, datë 6.8.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.
- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" , ERE me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Biopower Green Energ" sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licencës nr. 64, seria NPM08P, datë 6.8.2008, për ndërtim, instalim, shfrytëzim të centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike të Parkut Eolik "BPGE 1" dhe "BPGE 2", Shëngjin, Lezhë, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 90, datë 6.8.2008.
2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k., nr. 64, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 90, datë 6.8.2008.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti